



**FAKULTETI**

**I**

**GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT**

**PROGRAMI STUDIMOR I STUDIMEVE DERI NË DIPLOMIM  
(Bachelor of Arts)**

**EMËRTIMI I PROGRAMIT:**

**GJUHËT EUROPIANE DHE STUDIMET  
GJUHË GJERMANE – GJUHË FRËNGE**

## HYRJE

Ndjekja e trendeve më të reja në arsimin a e lartë vetvetiu kërkon modifikimin e programeve të vjetra dhe programe dinamike, të reja, të cilat ofrohen nga ana e një institucioni.

Një nga prioritetet e Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit është përfshirja në ato suaza zhvillimore dhe në realizimin e programeve sa më të mira, të cilat do t'u ofrohen gjeneratave të ardhshme me qëllim të përgatitjes së tyre sa më të mirë për të hyrë në sferat dhe e botës shkencore.

Vendi ynë tanimë disa vite po përgatitet për të hyrë në familjen e madhe europiane, ku vlerat e përbashkëta çmohen lartë. Qëllimi primar i këtij programi është t'ju mundësojë studentëve në studime pasuniversitare formim profesional në fushën e studimeve gjermane. Çdo vend që ka hyrë në UE ose tenton për të hyrë, duhet të bëjë ndryshime në shumë fusha, ndërsa pashmangshme është edhe fusha hulumtimeve shkencore.

Gjermania është vendi ku është prodhuar ideja për Europën dhe Unionin European. Pas më shumë viteve, ky vend, aq shumë është afruar me ç'rast edhe bashkëpunimi me të paraqet një shtysë në proceset, të cilat aktualisht zhvillohen në Union dhe njëkohësisht paraqet model të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Ekzistimi i një programi që do të bazohet në mësimin dhe njohjen e gjuhëve, kulturave të tyre, letërsisë, civilizimeve, do të ishte me rëndësi të madhe për një vend siç është Maqedonia.

Të bëhesh bilinguist dhe të njihet gjuha gjermane dhe shqipe është një sfidë e madhe jo vetëm për studentët, por edhe për çdo njeri. Europa kërkon nga Maqedonia të jetë e gatshme dhe të përgatisë kuadro, të cilët do të mund të barazohen me kolegët e tyre të vendeve perëndimore, si dhe të posedojnë aftësi që të ballafaqohen me sfidat që janë vënë para vendit tonë.

UEJL-ja në Tetovë i ka të gjitha mundësitë, kurse Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ka kushte dhe kuadër për t'u mundësuar studentëve përgatitje sa më të mirë, të cilët në të ardhmen do të jenë profesionistë të vërtetë në sferën e gjuhëve dhe studimeve europiane.

## **PROGRAMI STUDIMOR I STUDIMEVE DERI NË DIPLOMIM GJUHËT EUROPIANE DHE STUDIMET – GJERMANISHT FRËNGJHISHT**

Programi studimor përfshin studimet deri në diplomim në gjashtë semestra. Pas përfundimit të këtij cikli të studimeve studentët e fitojnë thirrjen “Bachelor of Arts”.

<b>Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit</b>	
Institucioni/Organi i dhënies së titullit	Universiteti i EJL
Institucioni mësimor	Universiteti i EJL
Vendi i mësimdhënies	Qyteza e UEJL
Programi i akredituar nga:	Bordi i Akreditimit
Shkalla përfundimtare shkencore	BA
Programi	Gjuhët europiane dhe studimet opsioni Gjermanisht –Frëngjisht
Data e përgatitjes/revizioni	Shtator 2007
Grupi i studentëve	Gjenerata e vitit akademik 2008/2009

### **1. Qëllimet arsimore të programit Gjuhët europiane dhe studimet**

Qëllimi i këtij programi është të përgatit kuadër profesional për njohjen e gjuhës, kulturës, civilizimit, metodologjisë së mësimin dhe të ligjëritimit të gjuhës gjermane, të cilat njëkohësisht do t’u përgjigjen sfidave të shekullit 21. Përveç njohjes së gjuhës gjermane dhe frënge, të diplomuarit e ardhshëm do të fitojnë njohuri edhe nga sfera e studimeve europiane, duke filluar nga njohuritë e përgjithshme të Unionit Europian, institucioneve të saj, politikën e saj përfshirë këtu edhe politikën gjuhësore. Duke i njohur këto dy gjuhë dhe duke pasur njohuri të përgjithshme nga sfera e studimeve europiane paraqet përparësi dhe mundësi më të madhe për vete dhe gjeneratat e ardhshme. Qëllimi i UEJL-së është t’ju ofrojë gjeneratave të ardhshme shanse më të mëdha, të cilat do t’ju mundësojnë të përsosën edhe më shumë për të qenë në nivel të njëjtë me kolegët e tyre të UE-së.

Ky program njëkohësisht është edhe bazë e mirë për të diplomuarit të cilët më vonë do të dëshironin që të regjistroheshin në Studimet pasuniversitare në programet eksistuese në vend, por edhe në programet që ofrohen jashtë.

### **Rezultatet e nxënies së mësimin**

Mësimi ju mundëson studentëve t’i zhvillojnë dhe t’i prezantojnë njohuritë, kualitetet dhe karakteristikat tjera të sferave si më poshtë:

<b>A. Njohuritë e fituara dhe parashikimet nga:</b>	<b>Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit që përdoren për të arritur dhe demonstruar rezultatet</b>
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Në fushën e gjuhëve europiane, opsioni gjermanisht-frëngjisht ofron njohje të shkëlqyeshme të këtyre dy gjuhëve.</li><li>2. Njohje solide nga sfera e gjuhëve europiane.</li><li>3. Gjuha angleze (obligative), për ç'gjë është rezervuar pjesa më e madhe e programit.</li><li>4. Aftësim dhe kompetencë në shumë sfera për të cilat ka nevojë shteti dhe shoqëria në përgjithësi</li><li>5. Përgatitje për angazhim aktiv në projekte udhëheqëse shkencoro-hulumtuese.</li><li>6. Me dijen e arritur shkencoro-profesionale, janë të përgatitur që të punësohen në institucione të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare dhe institucione, por edhe në përdorimin praktik të gjuhës gjermane dhe frënge.</li></ol>	<p><b>Ligjëratat/mësimi</b></p> <p>Mësim interaktiv dhe tradicional; Punë seminarike nën udhëheqjen e tutorëve; Hulumtim i pavarur, Vecanti lideri</p> <p>Aplikimin praktik të dijeve në jetën shoqërore dhe politike.</p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Në kuadër të programit të lëndës, vlerësimi mund të bëhet përmes këtyre komponenteve:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Prania në ligjërata</li><li>• konsultime;</li><li>• Ushtrime të realizuara me sukses;</li><li>• Sukse gjatë punës praktike;</li><li>• Punimet seminaike;</li><li>• Provimi përfundimtar;</li><li>• Punë ekipore;</li><li>• Projekte të realizuara</li></ul>
<b>B. Shkathtësi dhe karakteristika të tjera</b>	
<b>Aftësitë e përgjithshme për transferimin e shkathtësive intelektuale.</b>	<b>Ligjëratat/mësimi</b>
<b>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund që:</b>	

- |  |   |
|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. T'i aplikonë njohuritë e tyre të fituara gjatë studimeve në mënyrë efikase për të analizuar çështjet komplekse nga studimet europiane, duke përdorur, sipas nevojës, gjuhët mësimore (gjuhën gjermane, frënge, shqipe, maqedonase dhe angleze).</li><li>2. T'i njohin dhe vendosin çështjet dhe problemet sipas rëndësisë së tyre.</li><li>3. T'i mbledhin dhe sintetizojnë të dhënat nga literatura gjermane, frënge, shqipe, maqedonase dhe angleze.</li><li>4. T'i dallojnë alternativat e tyre për problemet e vecanta dhe të bëjnë zgjedhje praktike midis tyre.</li><li>5. T'i shprehin në mënyrë konstruktive proceset e mësimi.</li></ol> | <p><b>Këto shkathtësi kryesisht zhvillohen përmes diskutimesh dhe argumentimit të punëve seminarike, prezantimeve dhe debateve në lëndë të caktuara.</b></p> <p><b>Vlerësimi</b><br/>Provimet me shkrim, vlerësimi i prezantimeve, punimet seminarike, punët individuale dhe ekipore.</p> |
|--|---|

<b>Ç. Aplikimi i shkathtësive speciale:</b>	<b><i>Ligjëratat/mësimi</i></b>
<p>a) T'i njohin problemet nga fusha e gjuhëve europiane, civilizimeve dhe kulturave, që janë rezultat i kompleksitetit të punës. multidimensional në sektorin publik.</p> <p>b) Të kryejnë analiza të përgjithshme dhe të veçanta nga fusha e Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit.</p> <p>c) T'i elaborojnë, nga aspekti shkencor dhe praktik, dallimet dhe nevojat e komunitetit.</p>	<p><b>Aftësia për zgjidhjen e problemeve kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në:</b></p> <p>Seminare, analiza dhe problemeve nga praktikat si dhe përmes punës praktike ku studentet nga afër janë përballur me multidimensionalitetin e problemeve në Fakultetin e Gjuhëve Kulturave dhe Komunikimit. Kjo metodë mundëson lidhjen e teorisë me praktikën, që është kusht i domosdosëhm për karrierë të suksesshme në institucionet e sistemit arsimor dhe organizatat tjera.</p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Kryhet përmes provimeve përfundimtare, kolokviumeve, përmes prezantimeve dhe punëve seminarike, si dhe sipas punimit të tezës dhe prezantimit publik, pas përfundimit të punës ekipore.</p>

Burimet, hulumtimet dhe vlerësimi	Ligjëtatat/mësimi
<p><i>Pas përfundimit të suksesshëm të programit, studenti do të mund:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Individualisht dhe në grup të punojnë në hulumtimin e formave më përkatëse të plotësimit të nevojave të shoqërisë, arsimimit, në lidhje me gjuhën, kulturat dhe komunikimin.</li> <li>b. T'i elaborojë, nga aspekti shkencor dhe praktik, dallimet dhe nevojat e bashkësisë.</li> <li>c. Aktivisht të kyçet në ndërtimin e sferës së arsimit, diplomacisë, kulturës dhe komunikimit publik.</li> <li>ç. Të jenë të informuar dhe të kontribuojnë në elaboratet shkencore dhe profesionale për njeriun dhe bashkësinë, e cila ka nevojë për kyçe në arsim, kulturë, komunikim, diplomaci etj.</li> </ul>	<p><i>Ligjëtatat/mësimi</i></p> <p>Ushtrime praktike, preantime individuale dhe në grup, sipas lëndëve në dy gjuhët. Veçanërisht, për lëndët obligative Letërsia frënge, Letërsia gjermane, Linguistika, Civilizimi, Kultura tradicionale, ku i kushtohet vëmendje e posaçme hulumtimit të trendeve të ndryshme në BE, SHBA dhe Maqedoni).</p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Bëhet në bazë të vlerësimit dhe analizave të problemeve nga praktika, të prezantimeve individuale dhe grupore, të punimeve seminarike etj.</p>

**D. Shkathtësitë kryesore:**

**Komunikimi dhe shkrimi**

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët aftësohen që:

- a. T'i përdorin, në të folur/me shkrim gjuhën gjermane, frënge, shqipe, maqedonase dhe angleze, lidhur me studimet europiane.
- b. Të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe efikase në dëshmimin gjatë diskutimeve për çështje komplekse në gjuhët europiane.
- c. Të bëjnë prezantim të qartë dhe koherent për ndonjë temë ose detyrë, duke e përdorur drejt literaturën e grumbulluar.
- ç . Të lexojnë materie komplekse, e cila është ose jo e lidhur me studimet europiane,
- d.Ta përdorin terminologjinë e nevojshme të gjuhëve europiane, vecmas gjuhën gjermane, frënge, shqipe, maqedonase dhe angleze.

***Ligjëratat/mësimi***

Kontribute seminarike, prezantimi në orë, diskutime, debat për lëndët. Gjatë vitit të parë do të arrihet një e folme e rrjedhshme në gjuhën shqipe/maqedonase, kurse do të arrihen edhe aftësi gjuhësore për përdorimin e terminologjisë nga fusha e studimeve europiane.

**Vlerësimi**

Notimi i punimeve seminarike, prezantimi sipas lëndëve, realizimi i punës praktike si dhe kontrollimi përmes provimeve me gojë dhe me shkrim, veçmas përmes testimit.

### **11. Struktura dhe kushtet e programimit studimor, nivelet, modulet, kreditë, mirënjohjet**

Mësimi ofrohet në bazë të rregullt (*full-time*) dhe me korrespondencë (*part-time*). Programet studimore në kozgjatje prej tri viteve (gjashtë semestra) për studimet deri në diplomim, gjegjësisht 180 ECTS-kredi.

Studentët ndjekin mësimin nga lëndët obligative dhe lëndët zjedhore. Lëndët përfshijnë kredi, që përafërsisht korrespondojnë me 25-30 orë, nga kohëzgjatja e mësimdhënies së ligjëratave. Çdo vit duhet të fitohen 60 kredi për 1.500 -1.800 orë në vit. Informata më të detajuara për politikën e kredive mund të merren në Katalogun e Universitetit. Lëndët ndahen njësi semestrale. Studentët duhet që t'i kryejnë të gjitha lëndët, sipas zhvillimit të programit të obliguarstudimor. Pjesëmarrja në ligjërata është e obligueshme dhe paraqet kusht primar që ta kalojnë lëndën me sukses. Çdo lëndë duhet të përfundojë, duke i plotësuar kërkesat e parashtruara në program (silabusin) e lëndës. Në semestrin e fundit, të gjashtin, studentët do të pajisen me dituri paktike dhe shkathësi përmes punës praktike, që është edhe kusht për të diplomuar në studimet deri në diplomim.

**PROGRAMI STUDIMOR I STUDIMEVE DERI NË DIPLOMIM  
GJUHËT EUROPIANE DHE STUDIMET – GJERMANISHT FRËNGJHSHT**

<i>Semestri 1</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Fillestar/i mesëm/ Gjuhë e avansuar angleze/angleze akademike	3	D	0	22	90	20-30
Gjuhë shqipe 1/Gjuhë maqedonase 1	3	D	0	22	90	20-30
Shkathtësitë e avansuara TI	3	D	11	11	90	20-30
Fonetika e gjuhës gjermane	3	D	11	11	90	20-30
Studimet europiane	6	D	30	15	180	20-30
Gjuhë frënge 1	6	D	0	45	180	20-30
Gjuhë gjermane 1	6	D	0	45	180	20-30
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>30</b>		<b>63</b>	<b>150</b>	<b>900</b>	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Fillestar /I mesëm/Gjuhë e avansuar angleze/Akademike angleze	3	V	0	22	90	20-30
Gjuhë shqipe 2/Gjuhë maqedonase 2	3	V	0	22	90	20-30
Gjuhë frënge 2	6	V	0	45	180	20-30
Morfologjia e gjuhës frënge	6	V	30	15	180	20-30
Gjuhë gjermane 2	6	V	0	45	180	20-30
Morfologjia e gjuhës gjermane	6	V	30	15	180	20-30
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>30</b>		<b>71</b>	<b>153</b>	<b>900</b>	

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

---

<i>Semestri 3</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë e avansuar angleze /Gj. akademike angleze.	3	D	0	22	90	20-30
Zgjedhor*	3	D	11	11	90	20-30
Gjuhë frënge 3	6	D	0	45	180	20-30
Sintaksa e gjuhës frënge	6	D	30	15	180	20-30
Gjuhë gjermane 3	6		0	45	180	20-30
Sintaksa e gjuhës gjermane	6	D	30	15	180	20-30
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>30</b>	<b>D</b>	<b>71</b>	<b>153</b>	<b>900</b>	

**\*Lëndë zgjedhore 1:**

1. Qendra e karrierës
2. Komunikimi interkulturor

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

<i>Semestri 4</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë e avansuar angleze	3	V	0	22	90	20-30
Fonetika e gjuhës frënge	3	V	11	11	90	20-30
Gjuhë frënge 4	6	V	0	45	180	20-30
Letërsia frënge	6	V	30	15	180	20-30
Gjuhë gjermane 4	6	V	0	45	180	20-30
Letërsia gjermane	6	V	0	45	180	20-30
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>		<b>41</b>	<b>183</b>	<b>900</b>	

<i>Semestri 5</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë gjermane 5	6	D	0	45	180	20-30
Civilizimi i hapësirës gjuhësore gjermane	6	D	30	15	180	20-30
Gjuhë frënge 5	6	D	0	45	180	20-30
Civilizimi i hapësirës gjuhësore frënge	6	D	30	15	180	20-30
**Lëndë zgjedhore (nga FAPSHP ose Fakulteti Juridik)	6	D	25	20	180	20-30
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>		<b>85</b>	<b>140</b>	<b>900</b>	

\*\*Lëndë zgjedhore:

1. Problemet politike të integritit europian
2. Hyrje në administratën publike
3. Politika arsimore
4. Historia e të drejtës europiane
5. E drejta ndërkombëtare publike
6. Marrëdhëniet ndërkombëtare
7. Organizatat ndërkombëtare



**Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore**

---

<i>Semestri 6</i>	<i>Kredi</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prak.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë gjermane 6	6	V	0	45	180	20-30
Metodologjia e mësimit të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj	6	V	30	15	180	20-30
Gjuhë frënge 6	6	V	0	45	180	20-30
Metodologjia e mësimit të gjuhës frënge si sigjuhë e huaj	6	V	30	15	180	20-30
Lëndë zgjedhore (nga FAPSHP ose Fakulteti Juridik)	6	V	30	15	180	20-30
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>		<b>90</b>	<b>135</b>	<b>900</b>	

\*\*\* Lëndë zgjedhore:

1. Problemet politike të integritit europian
2. Hyrje në administratën publike
3. Politika arsimore
4. Historia e të drejtës europiane
5. E drejta ndërkombëtare publike
6. Marrëdhëniet ndërkombëtare
7. Organizatat ndërkombëtare

\*\* Fakulteti e mban të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të listës së lëndëve të lira zgjedhore, varësisht nga nevojat, kërkesës së studentëve dhe mbulesës kadrovike të lëndëve

## PËRSHKRIMI I LËNDËVE

### SEMESTRI 1-6

#### Shkathtësitë e avansuara TI:

Një semestër i studimeve intensive nga shkathtësitë e TI jo vetëm që do t'i pasurojë dijet e studentëve dhe t'i aftësojë ata që t'i shfrytëzojnë teknologjitë në mjedise akademike, ata do të mund që në botën e vërtetë t'i përdorin shkathtësitë në tregun e punës, duke iu mundësuar konkurrencë në vendin e punës.

#### Studime europiane:

Kjo lëndë paraqet lëndën bazike që mësohet në të gjitha fakultetet e UEJL. Bëhet fjalë për një lëndë njësemestrale që mësohet në ndonjërin nga semestrat (nga semestri i parë deri në të tretin). Programi i kësaj lënde mbulon njohuri bazike në lidhje me:

- Europën,
- Historinë e Europës,
- Kultura, civilizimi dhe vlerat europiane,
- Identiteti europian,
- Institucionet e Europës.

#### Gjuhë frënge 1-6:

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i forcojë bazat linguistike të njohjes së gjuhës dhe t'i zhvillojë të katër komponentet e komunikimit, sidomos të dinë të shprehen në këto sfera:

Të dinë të shprehin mendim,

- Të dinë të shprehin ndjenjat,
- Të dinë të dallojnë idenë,
- Të dinë të prezantojnë ide të qarta,
- Të dinë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre.
- Të dinë të gjenden në situata të ndryshme,
- Të mbajnë diskutim të thjeshtë dhe koherent,
- Të rrëfejnë ndonjë ngjarje,
- Të tregojnë ëndrrën ose përvojën,
- Të paraqesin shkaqet e një projekti ose ideje,
- Të komunikojnë spontanisht.

Në këtë lëndë është paraparë që njëkohësisht të mësohen edhe elementet e përkthimit, gjegjësisht të gjitha llojet e përkthimit siç janë: konsektiv, simultan, ndërlihdës etj. Paraprakisht, organizohet testi i evaluimit për nivelin me anë të të cilit konstatohet niveli aktual i njohjes së gjuhës për studentët, të cilët duan të regjistrohen në vitin e parë. Niveli i kërkuar është A1.

### **Fonetika e gjuhës frënge**

Në semestrin e parë përfshihet një pjesë e materialit ku studentët mësojnë për historinë e komponenteve fonologjike, fonemat, formimin e tyre dhe mënyrën e ndarjes në grupe dhe nëngrupe.

### **Morfologjia e gjuhës frënge**

Në semestrin e dytë gjithçka fillon me shprehjen morfologji, vazhdon me shprehjen emër, mbiemër dhe përfundon me numrat. Mësohen të gjitha fjalët e ndryshueshme. Shembujt (prova), propozimet, lidhëzat, pasthirrmat etj. Pas mbarimit të kësaj pjese, studenti duhet të ketë koncept të qartë për të gjitha fjalët.

### **Sintaksa e gjuhës frënge**

Në semestrin e tretë është përeëparë që të mësohet Sintaksa me një vështrim të përgjithshëm. Tipologjia e fjalisë, struktura e saj, sintagma. Karakteristikat sintaksore të fjalisë, përbërja e brendshme e fjalisë, operacionet e nevojshme me ndihmën e të cilave bëhet analiza sintaksore e fjalisë. Karakteristikat e modaliteteve të fjalisë 1 dhe 2, definicioni i fjalisë, tipologjia e saj në bazë të kategorive, fjalitë e varura, fjalitë kryesore etj. Në program janë paraparë edhe fjalia e thjeshtë dhe e zgjeruar dhe karakteristikat e saj.

Programi realizohet me nga dy orë në javë, edhe atë: një orë ligjërata dhe një orë ustrime.

### **Letërsia frënge**

Kjo lëndë parasheh një mënyrë më të gjërë për mësimin e shkrimtarëve të vjetër, veprat e të cilëve kanë rëndësi historike, gjuhësore dhe letrare. Hyrja në letërsinë e vjetër frënge dhe gjermane, e përpunuar shkencërisht dhe përplot me të dhëna dhe analiza bashkëkohore për autorët dhe veprat, të cilat i përkasin kësaj periudhe të letërsisë. Lënda ka ndryshime konceptualo-strukturore, duke i pasur parasysh disa formulime dhe grupime të reja të shkrimtarëve, sipas karakterit të veprave të tyre. Kjo materje e zhgjedhur e plotëson

shprazëtirën e dukshme dhe akceptorët akutë, të cilët kërkojnë njohjen e filleve të letërsisë së këtyre dy kombeve të mëdha. Në bazë të sprehjes së definuar “kultura” e civilizimit nacional, ne do të mundohemi që t’i zbulojmë aspektet më relevante të shoqërisë bashkëkohore shqiptare. Ky kurs, ofron dije themelore përmes disa sferave kyçe. Kjo lëndë do t’i analizojë letërsinë dhe kulturën në një perspektivë europiane. Ora e civilizimit do t’i trajtojë të gjitha vendet, ku flitet gjuha gjuha frqngje.

### **Civilizimi hapësirës gjuhësore frënge**

Lënda Civilizimi i hapësirës gjuhësore frange është lëndë, ku studentët mësojnë dhe akumulojnë shumë informacione, të cilat në rend të parë kanë të bëjnë me Francën dhe karakteristikat e saj, organizimin e saj administrativ dhe institucional, vendin e saj në familjen e madhe europiane, marrëdhëniet e saj me vendet tjera, që të vazhdohet më tej me të gjithë atë që paraqet trashëgimi kulturore, ku përmenden të gjitha gjërat e rëndësishme që janë të pranishme në Francë. Gjithashtu, studentët njihen me frankofoninë dhe vendet anëtare të ONF (Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë), aksionet dhe veprimet e tyre, duke përmendur këtu faktin se edhe Republika e Maqedonisë është anëtare e përhershme e kësaj organizate të mirënjohur. Në pjesën e dytë të formacionit, studentët mësojnë edhe shumë punë për jetën sociale, siç janë: politika, miqësia, lëvizjet, shkuarja në shkollë, studimet, puna, familja, pushimi, mediumet etj. Kur studentët t’i kenë akumuluar të gjitha këto njohuri, atëherë kalohet në trashëgiminë kulturore dhe të letërsisë së Francës, duke përmendur këtu elementet, siç janë: stereotipet, ngjashmëritë dhe veçoritë ndërkulturore midis fracezëve dhe popujve të tjerë, duke tërhequr njëkohësisht paralele me kushtet e Maqedonisë dhe me nënqiellin e Maqedonisë.

### **Metodologjia e mësimi të gjuhës frënge si gjuhë e huaj**

Metodologjia e mësimi të gjuhës frënge me programin e ri është paraparë që të realizohet me studentët e vitit të tretë.

Materia e këtij programi është e gjërë dhe ka të bëjë me format dhe metodat më të reja të metodologjisë bashkëkohore të të mësuarit të kësaj lënde. Në thelb, këtu janë përfshirë metodat, format, teknikat, organizimi i orëve dhe i gjuhës dhe letërsisë me karakteristikat e saj specifike. Theksi është vënë në organizimin e orëve në grupe (një lloj i mësimi interaktiv), që kohët e fundit është përhapur gjithkund.

Programi realizohet me dy orë në javë, në një orë ligjërata, kurse në orën tjetër vazhdimisht ushtrime.

## **Fonetika e gjuhës gjermane:**

Qëllimi i kursit është që t'i njohë studentët me problemet e fonetikës dhe fonologjinë e gjuhës gjermane, me procesin e artikulimit, organet e artikulimit dhe vendet artikulimit etj. dhe me sistemin e zërave në gjuhën gjermane (bashkëtingëlloret, konsonatat, diftongjet), në krahasim me ato në gjuhën shqipe; të njihen me shenjat diakritike dhe transaksionin ndërkombëtar fonetik, si dhe fonetikën supranacionale, theksin e fjalës në fjali, intonimin etj.

## **Gjuha gjermane 1**

Studentët bëjnë ushtrime për në të shprehurit e drejtë dhe intonimin e fjalëve, për formën e gramatikës së njësuar dhe semantikën e fjalive, si dhe rregullat themelore të drejtshkrimit.

Gjithashtu, studentët lexojnë tekste të niveleve më të ulëta, sic janë: dialogjet, letrat, rrëfimet, përshkrimet etj.

Fjalët themelore që përdoren në të shprehurit e përditshëm gjithashtu do të përpunohen. Pikat kryesore gramatikore janë: Präsens/ Perfekt / Präteritum/ Plusquamperfekt der Verben, trennbare Verben, reflexive Verben, Modalverben etj.

## **Gjuhë gjermane 2**

Studentët bëjnë ushtrime me një vokabular më të ndërlikuar, lexojnë tekste që janë të lidhura me studimet e tyre, familjen, udhëtimin, pushimin, kulturën, sportin hobi etj. Nga ana jetër, ata ushtrojnë të shkruarit e paragrafëve, shkresa formale, CV, intervista, raporte etj.

Orët mbahen si një lloj konverzacionesh dhe diskutimesh të thjeshta në bazë të materialit të dhënë paraprakisht.

Pikat kryesore gramatikore janë: Verben mit Akkusativ und Dativ, Passiv, Imperativ, Konjunktiv I, Konjunktiv II, Verben mit Infinitiv.

## **Morfologjia e gjuhës gjermane:**

Ky kurs ka për qëllim të japë një pasqyrim për gramatikën e foljeve, duke u fokusuar në aspektet sistemore dhe funksionale gjuhësore. Në kuadër të këtij kursi do të shqyrtohen temat në vijim: gramatika me funksionet e saj, struktura fonologjike, morfologjike, sintaksore dhe semantike e fjalës. Kriteret morfologjike, sintaksore dhe semantike për përcaktimin dhe definimin e pjesëve mësimore. Foljet, klasifikimi i foljeve sipas kriterëve morfologjike, sintaksore dhe semantike (foljet infinite dhe joinfinite), foljet absolute, foljet relative, foljet tranzite dhe intranzitive, foljet ndihmëse, foljet refleksive,

foljet funksionale etj. Forma dhe funksioni konjugtimit. Sistemi i kohëve. Aktiv dhe pasiv, indikativ, konjuktiv dhe mperativ etj.

### **Sintaksa e gjuhës gjermane:**

Ky kurs, ka për qëllim t'i njohë studentët me konceptet bazike të sistaksës së gjuhës gjermane, respektivisht se si të ndërtohet një fjali. Në kuadër të këtij kursi, në rend të parë do të shqyrtohen temat në vijim: Konceptet themelore të sistaksës së gjuhës gjermane. Çka është fjalia. Pjesët e fjalisë. Llojet dhe format e fjalisë, fjalia e thjeshtë. Aktantët dhe cirkumstantat; Dallimi midis aktantave dhe cirkumstantave. Fjalia e zgjeruar; parataksa dhe hipotaksa. Forma e fjalive të varura, të veçanta dhe plotësuese.

### **Gjuhë gjermane 3:**

Interesi kryesor i këtij kursi është zhvillimi i mëtutjeshëm i të gjitha katër shkathtësive gjuhësore, veçanërisht komunikimit.

Monologjet dhe dialogjet do të përpunohen përmes temave gjegjëse të ndryshme: shkencës, artit, medimeve, kulturës, historisë, kohës së lirë, dashurisë, miqësisë etj. Për të gjitha këto tema, do të ofrohen tekste dhe ushtrime të ndryshme, përmes së cilave do të përsoset fondi i përgjithshëm dhe terminologjik i të folmes. Gjithashtu, ekzistojnë mundësi diskutimi dhe argumentimi të problemeve, ritregimi dhe përshkrimi të tyre. Pikat kryesore gramatikore janë: Adverbialsätze, Zeitformen, Komposita, Präfigierung, Modalverben, Attribution etj.

### **Letërsia gjermane**

Hyrje në analizën e interpretimit të veprave letrare:

- a) Hyrje dhe ushtrime të aplikimit të teorive shkencore të letërsisë dhe intepretimimit letrar;
- b) Hyrje në teorinë dhe në veprat më të theksuara të zhanreve më të vogla poetike dhe letërsisë epike, të cilat shfrytëzohen si paradigmapër aplikimin e koncepteve të teorisë së interpretimit.

### **Gjuhë gjermane 4**

Interesi global i këtij kursi është zhvillimi i mëtutjeshëm i të gjitha katër shkathtësive gjuhësore, veçanërisht shkrimit. Gramatika e përsosur gjuhësore, kompozicioni i udhëhequr, konverzimi, shkrimi i eseve dhe diskutimi për kulturën, të

bazuar në tekstin e lexuar. Pikat kryesore gramatikore janë: Attribution, Konnektoren und Präpositionen, Verbal – und Nominalstil, e përmirësojnë korrektësinë në komunikim.

### **Gjuhë gjermane 5**

Në bazë të teksteve dhe videoprezantimeve autentike të teksteve aktuale dhe videoprezantimeve, studentët do të kenë mundësi të ushtrojnë komunikimin përmes monologjeve dhe dialogjeve, gjatë diskutimeve të tregojnë reagime pëkatëse dhe spontane. Gjithashtu, do të ushtrojnë edhe forma të pajtimit dhe mospajtimit dhe reagime ndaj ideve dhe propozimeve.

### **Civilizimi i hapësirës gjuhësore gjermane:**

Hyrje në teorinë dhe filozofinë e kulturës dhe të civilizimit. Diskutim rreth koncepteve themelore, terminologjisë dhe termave, leximi dhe diskutimi rreth teksteve dhe eseve të autorëve më të njohur të marrdëhënieve kulturologjike, veprat civilizueso-teorike. Epokat kryesore të historisë europiane dhe gjermane, të kulturës dhe civilizimit: antika, mesjeta, ndryshimet dhe revolucionet në stilin jetësor dhe civilizimin nga fillimi i kohës më të re: renesansa, reformacioni, arsimimi evropian, revolucioni frëng, regimi romantik, industrializimi, kolonializmi, imperializmi, militarizmi, destruksioni i humanizmit midis 1914 dhe 1945. Zhvillimi në shenjë të globalizimit pas vitit 1945.

### **Gjuha gjermane 6**

Studentët do të shfrytëzojnë tekste më të ndërlikuara dhe më të gjata për lexim, do ta analizojnë dhe kritikojnë informacionin e tyre. Në mënyrë plotësuese, studentët do të jenë në gjendje që t'i ushtrojnë të gjitha llojet e shkrimit akademik, vështrimin kritik ndaj teksteve të tjera si dhe prezantimin gojor në sfera të ndryshme.

### **Metodologjia e mësimit të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj**

Hyrje në konceptet dhe modelet themeore të metodikës dhe didaktikës së gjuhëve të huaja dhe të gjermanishtes si gjuhë e huaj. Leximi dhe diskutimi i debateve të sotme më aktuale dhe më të rëndësishme metodologjiko-didaktike. Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj me orientim praktik mësues. Leximi, implementimi i koncepteve dhe programeve të mësimit praktik në sferën e gjermanishtes si gjuhë e huaj, principet bashkëkohore të mësimit, refleksionet bashkëkohore të gjermanishtes si gjuhë e huaj, përgjigja kritike dhe kundërmodelet e programeve ekzistuese, librat dhe mjetet tjera ndihmëse mësimore.